

ERËRA TË FTOHTA PO FRYJNË NË MBARË EVROPËN. ERDHI ÇASTI PËR NJË POLITIKË MË TË NGROHTË.

Ne, Partia e Gjelbër Suedeze, dëshirojmë të jemi zëri i ngrohtë në Parlamentin Evropian. Ne jemi antiteza, kur bën ftohtë, kur erërat ksenofobe po përfshijnë gjithë Evropën dhe teksa kufijtë e jashtëm po mbyllen për njerëzit në nevojë. Kur shohim sulme kundra paradave të krenarisë dhe mënyrën se si trajtohen në Evropë nevojtarët për azil dhe romët, ne ndihemi fuqiplotë për idenë tonë se BE-ja ka nevojë për më shumë politikanë të gjelbër. Ne dëshirojmë të punojmë për një Evropë humane, ku të drejtat e njeriut zbatohen për të gjithë njësoj, pavarësisht se ku jetojnë.

Për sa i përket politikës të ruajtjes së mjedisit, BE-ja po përballet me detyrën e rëndësishme të zgjedhjes së rrugës së duhur. Partitë konservatore duan të heqin dorë nga qëllimet ambicioze në lidhje me klimën dhe të vendosin interesat e bizneseve të mëdha më lart se e ardhmja e fëmijëve tanë. Përkundrazi, ne Partia e Gjelbër duam që BE-ja të ndërgjegjësohet dhe të luftojë kundër ndryshimeve klimatike. Për këtë arsye nevojiten më shumë parlamentarë evropianë të Partisë së Gjelbër! BE-ja mund të jetë një lider botëror brenda politikës të ruajtjes së mjedisit, por pjesa më e rëndësishme janë politikanët për të cilët do të votoni ju vetë.

Forca drejtuese brenda Partisë së Gjelbër Suedeze është përgjegjësia që ne ndjejmë për fëmijët dhe nipërit e mbesat tona, të cilët duhet të thithin ajër më të pastër, të pinë e të lahen në ujëra të pastra dhe të rriten pa asnjë kimikat në brendësi të organizmit të tyre.

Vendimet e BE-së ndikojnë në ushqimet që hani dhe blini, në të drejtat tuaja në internet, në mundësitë për të udhëtuar nëpër Evropë e në shumë më tepër se kaq. Ne duam që ushqimi juaj të mos përmbajë kurrsesi helme dhe mos ta ketë origjinën nga kafshë të keqtrajtuara. Ne i japim përparësi investimeve në udhëtime të thjeshta me tren në vend të fluturimeve dhe nëpër autostrada. Ne duam riciklimin e mbeturinave plastike në vend të hedhjes së tyre në det. Ne i themi JO survejimit në masë dhe i themi PO marrjes së kontrollit të të dhënave në internet nga ju vetë.

BE-ja duhet të përqendrojë punën e saj në çështjet tona të zakonshme - në rrezikun që i kanoset mjedisit, problemet mjedisore përtej kufijve dhe të mbrojtjes të së drejtave të njeriut. Në Partinë e Gjelbër Suedeze, ne kemi treguar se mund të jemi era e ndryshimit në politikën e BE-së. Bashkë me qytetarët dhe lëvizjet popullore, ne dhe miqtë tanë të gjelbër evropianë kemi arritur të ndryshojmë strategjinë e BE-së për peshkimin, e cila për herë të parë po vendos si qëllim të saj primar krijimin e rezervuarëve të peshkut. Gjithashtu ne kemi përmirësuar mënyrën e mbrojtjes ndaj kimikateve të rrezikshme dhe për të shumtën herë kemi mbrojtur lirinë e fjalës të shtetasve të ndryshëm dhe integritetin e tyre personal.

Partia e Gjelbër Suedeze është e rëndësishme për mënyrën e ndërtimit dhe funksionimit të BE-së. Prandaj ne punojmë për të ndryshuar Bashkimin Evropian. Ne duam të penetrojmë më në thellësi të procesit të vendimmarrjes së BE-së dhe të luftojmë për konceptin e aksesit publik në regjistrat zyrtarë të institucioneve të BE-së.

Ne mendojmë se vendimet duhen t'u afrohen sa më shumë të jetë mundur të gjithë personave që preken prej tyre. Shumë çështje për të cilat vendos BE-ja është shumë më mirë të diskutohen në nivel kombëtar, rajonal ose lokal. Parlamentet e vendeve anëtare kanë nevojë për mundësi më të mëdha të kontrollit, në mënyrë që BE-ja të mos vendosë për çështje që nuk i takojnë.

Ne duam të punojmë për një bashkëpunim më fleksibël të BE-së, ku çdo shtet të mund të zgjedhë, brenda një qëllimi të arsyeshëm, çështjet në të cilat dëshiron të marrë pjesë. Partia e Gjelbër Suedeze nuk dëshiron kurrësi shndërrimin e BE-së në një federatë evropiane. Por dëshiron që çdo shtet në Evropë që përmbush kërkesat bazë të demokracisë dhetë të drejtave të njeriut të ketë të drejtë të anëtarësohet.

KANDIDATËT TANË:

Isabella Lövin

“Deti dhe ajri nuk njohin kufij. Nëse do të diskutojmë për zgjidhjen e problemeve mjedisore dhe sipërfaqet ujore, atëherë BE-ja përbën arenën më të mirë ku mund të arrihet ndryshimi. Konferenca më e madhe e radhës e mjedisit në Paris, në vitin 2015, është mundësia botërore. Asnjë fuqi tjetër madhore nuk mund të marrë në dorë drejtimin, ndaj ne duam të garantojmë hedhjen e këtij hapi nga BE-ja”

”Personalisht dua gjithashtu të vazhdoj të punoj për një mjedis ujor më të pastër. Peshkimi pa kriter, acidifikimi i sipërfaqeve detare, fertilizimi i tepruar, derdhja e kimikateve dhe mbeturinave në rajonet arktike përbëjnë çështje që duhen trajtuar në nivel evropian dhe global. Ja se për çfarë dua të punoj me ju. Unë e di se Parlamenti Evropian mund të sjellë ndryshimin e dëshiruar, ndaj vota juaj është e rëndësishme!

Peter Eriksson

“Demokracia dhe transparenca janë zgjidhja. Sot, kanë nisur të ngrihen mure kundra gjithçkaje na rrethon. Gjithmonë e më shumë njerëz po diskutojnë të drejtën e qarkullimit të lirë midis shteteve të BE-së. Nëse kjo ëndërr e keqe bëhet realitet, atëherë ky veprim do të jetë një hap i tmerrshëm mbrapa.

”BE-ja mund edhe të caktojë kritere më rigorozë dhe të vendosë rregulla të qarta individuale për çdo shtet anëtar me qëllim uljen e korrupsionit dhe diskriminimit. Në këtë mënyrë, nëpërmjet zgjedhjeve të Parlamentit Evropian, ju mund të kontribuoni për shoqëri më të mira dhe funksionale në kontinentin tonë.

Tani juve ju jepet mundësia të përdorni zërin tuaj për ta bërë Evropën një vend më të mirë. **Ndryshoni Evropën, votoni për gjelbërimin.**